



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 85

Prishtinë, më 12.9.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2 Anex

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi.

Mungoi : Liburn Aliu dhe Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar të evidentuar dhe ekspertët Fatos Lajçi, Haki Tahirukaj dhe Izet Osmani.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 4.9.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjeve për parqe nacionale,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.9.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.9.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjeve për parqe nacionale

Kryetari i Komisionit njoftoi komisionin për kohën e shfrytëzuar rreth shqyrtimit të Projektligjit për Bjeshkët e Nemuna dhe të Sharrit gjë e cila tregon se ka ardhur koha të përfundoj shqyrtimi i këtyre dy projekteve. Në debatet e organizuara është konstatuar se shumica miratojnë këto dy projekte me vërejtje pronësore (në Pejë etj) për të cilat vërejtje Komisioni ka pasur parasysh dhe janë sugjeruar amendamente me të cilat garantohet se çështjet pronësore do të rregullohen me Ligjet e pronës, Denacionalizimit etj, e assesi me këto dy Ligje , ngase me to vetëm shpallen parqet. Ai konstatoi se djegëjet e shkaktuara në muajin gusht nëpër pyje tregojnë se duhet të jemi shumë më të vëmendshëm, ndaj propozoi komisionit amendamentet, të cilat pasi të detalizohen edhe nga ekspertët prezent, duhet të rekomandohen për procedim të mëtejshëm. Këto amendamente, vazhdoi, kanë parasysh që të mirat e natyrës duhet të mbrohen dhe të shfrytëzohen ashtu si parashihet sipas Ligjit, gjithashtu selia për parkun e Bjeshkëve të Nemuna të jetë në Pejë prej Janarit 2013, me një departament në Prishtinë që do të menaxhoi të dyja parqet bashkë.

Nijazi Idrizi mbështeti amendamentet e propozuara por kërkoi nga ekspertët të sugjerojnë nëse ka ndeshje në mes shfrytëzimit ekonomik të parkut me vet parkun nacional, ai gjithashtu kërkoi përkufizimin e FAO për parqe në mënyrë që të shohim se a jemi në vijën e duhur. Reagoi **Kryetari** dhe tha se me këto amendamente nuk ka vend për një brengosje të tillë, ngase të gjitha shfrytëzimet e parqeve siç janë sanitare, tradicionale dhe ekonomike janë të parapara me këtë ligj dhe sipas zonave. **Fatos Lajçi** njoftoi se në cilësinë e ekspertit vazhdimisht është në bisedime, ndërsa për zyrtarët e Pejës pohoi se janë PRO parqeve me vërejtjet se duhet ende të bëhen sqarimet e duhura për parqet nacionale, u pajtua se parqet nuk duhet të shfrytëzohen për biznese dhe pyeti për Ligjin e Natyrës a lejon koncesionin dhe kërkoi mundësinë e buxhetit të veçantë për parqe, për çka **Kryetari** tha se koncesionet lejohen në zonën e tretë ku do të mund të lejohen objektet për pushime nëpër prona private etj, ndërsa për buxhet u përgjigj që së pari duhet të miratohet Ligji pastaj të kërkohen vijat buxhetore nga Qeveria, ndryshe jo.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

- Të mbahet takimi i Komisionit të premtën me dy ministrat e ftuar, të MB dhe MMPH kur edhe përfundimisht Komisioni do të rekomandoi amendamentet për këto dy Projektligje.
- Në mbledhjen e së premtes do të shqyrtohet edhe propozimi për ekspertin e dytë për Projektligjin e Regjistrimit të Bujqësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 11,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani